

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT

"IRTech Renewables" sh.p.k

Sot ,me datë **24.02. 2025** themeluesit e mëposhtëm vendosën krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "IRTech Renewables" sh.p.k

1. Z.Igli Reçi , shtetas Shqipëtar, lindur më 07/05/1995 në Shkodër, Shqipëri me numër personal J50507079B , me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

KAPITULLI I

EMRI I SHOQËRISË- SELIA- KOHËZGJATJA-OBJEKTI

Neni 1

Emri

- 1.1. Shoqëria do të quhet "IRTech Reneables" sh.p.k. (Këtu e më poshtë "Shoqëria")
- 1.2. Shoqëria do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjësi të kufizuar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- 1.3. Shoqëria ka logon dhe vulën e saj zyrtare.

Neni 2

Selia

- 2.1. Selia e shoqërisë do të jetë tek Rruga Kongresi i Lushnjes, Z.K 8220, Nr.P4/532-N1, Tirane, Shqiperi.



Neni 3

Kohëzgjatja

- 3.1. Kohëzgjatja e Shoqërisë është e palimituar.

Neni 4

Objekti

- 4.1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:

a) Projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve për prodhimin e energjisë dhe infrastruktura e impianteve. Kërkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave për prodhimin e energjisë. Asistenca teknike, riparime dhe mirëmbajtja e aparaturave për prodhimin e energjisë. Import- eksporti, tregëtimi me shumicë dhe pakicë i energjise elektrike, mallrave, materialeve dhe aparaturave që lidhen me kryerjen e aktivitetit në fushën e energjisë. Instalimi dhe ndërtimi i impianteve energjitike nga burime të rinovueshme nga dielli, era, uji, etj. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë elektrike. Importi dhe eksporti i mallrave e paisjeve të teknologjisë në fushën e energjitikës, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e centraleve fotovoltaike e forma të tjera të prodhimit të energjisë të ushqyera nga burime të ndryshme dhe nga ato të caktuara si: hidrike, diellore, me erë, biomasa etj. Mirëmbajtja e centraleve energjitike. Zhvillim të projekteve në sektorin e energjive të rinovueshme, ndërtimin dhe mirëmbajtje të punimeve civile, objekteve të ndryshme, linjave elektrike.


KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR

NENI 5

Kapitali Themeltar

- 5.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 10 000 (dhjetë mijë) lekë i përbërë nga 1 (një) kuotë.
- 5.2. Kapitali i shoqërisë përbehet nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 10 000 (dhjetë mijë) lekë.



5.3. z. Igli Reçi zotëron 100 % te kapitalit të shoqërisë në vlerë 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

5.4. Kapitali mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit te asamblesë së ortakëve themelues. Kuota e pjesëmarrësve në kapital janë të gjitha të emëruara dhe të pa ndashme. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

NENI 6

6.1. Ortaku që ka ndërmend të shesi kuotat e tij tërësisht, apo pjesërisht duhet më parë të njoftojë ortakun tjetër të shoqërisë. Ortaku tjetër ka të drejtën e blerjes së parë. Këtë të drejtë ortaku duhet ta ushtrojë brënda 30 Ditëve nga dita e njoftimit.

6.2. Në rastin e mos ushtrimit të së drejtës së blerjes së parë, ortaku që do të shesë kuotat duhet të njoftojë emërin e blerësit dhe kushtet, të cilat nuk duhet të jenë më të favorshme se sa ato të afuara ortakut tjetër të shoqërise.

NENI 7

7.1. Kapitali i shoqërisë përbehet, nga kapitali fillestar plus shtesën e bëre, mjetet e xhiros, pasuri te luajtshme ose te paluajtshme etj. të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

NENI 8

8.1. Kuotat e kapitalit janë te pasqyruara dhe të regjistruara në librat e llogarisë të shoqërisë.

NENI 9

9.1. Heqja dorë e ortakut nga bashkëpunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet që kanë lindur para se ai te largohet. Po kështu ai fiton dhe të drejtat që janë krijuar para largimit të tij.

NENI 10

10.1. Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë dhe që konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakëve në proporcion me përqindjen e kapitalit të investuar, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

10.2. Kapitali i investuar nga ortakët nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar në ligj .

NENI 11

11.1. Shoqëria është përdoruese dhe disponuese e pasurisë se saj. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, materiale ose jo materiale, duke përfshire edhe të drejtën për shitjen e pasurive të veta tek te tjerët.

11.2. Në Republikën e Shqipërisë shoqëria gëzon të drejta sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj ne përputhje me legjislacioni ne fuqi.



NENI 12

12.1. Shoqëria vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat e detyrimit vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët themelues të shoqërisë, mbartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kuotave të kapitalit të investuar në të. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet që ortakët ka pasur përpara se ajo të krijohet.

KAPITULLI I III

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 13

Kompetencat e ortakut

13.1. Ka të drejtë të administroj aktivitetin e shoqërisë, konform objektit të veprimtarisë së saj, duke përfshirë edhe veprimtarinë prodhuese e tregtuese që Shoqëria mund të kryej, vlerat e saj intelektuale e ekonomiko-financiare. Kanë të drejtë të marrin dijeni për rezultatet ekonomiko-financiare në çdo fazë të aktivitetit të saj. Kanë të drejtë të marrin pjesë vetë ose me anë të përfaqësuesve në këtë aktivitet.

13.2. Kanë të drejtë të tërheqin të gjitha dokumentet kryesore të shoqërisë për tre vitet e fundit

13.3. Kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe mund të shesin pjesën e kapitalit të tyre në përputhje me kushtet që i lejon statuti dhe ligji.


13.4. Ortakët në përputhje me statutin e aktin e themelimit dhe legjislacionin në fuqi kanë, të drejtë që në të njëjtën kohë të jenë ortakë edhe në shoqëri të tjera.

13.5. Ortakët rezervojnë të gjitha të drejtat sipas ligjit Tregtar.

NENI 14

14.1. Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj *z. Igli Reci*, lindur më 07/05/1995 në Shkodër, Shqipëri me numër personal J50507079B, me zotësi të plotë juridike për të vepruar i cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare;

14.2. Nënshkrimi i administratorit:

 Igri Reci 

NENI 15

Administrimi i shoqërisë

- 15.1. Administratori ka të gjitha të drejtat dhe fuqitë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë, me qëllim që të arrijë objektivat e saj, përveç atyre që ligji ia atribuon ortakëve.
- 15.2. Administratori përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët si dhe para organeve të administratës dhe atyre gjyqësore.
- 15.3. Administratori përgjigjet individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të treteve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për dëme të kryera gjatë administrimit. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi ndaj administratorit.
- 15.4. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të asamblesë së ortakëve.
- 15.5. Administratori ka të drejtë të veproj, firmosi pranë çdo organi administrativ, banke të nivelit të dytë dhe ku të shikohet e arsyeshme për të ushtruar aktivitetin e shoqërisë.
- 15.6. Shoqëria administratohet të pakten nga 1(një) dhe maksimumi 3(tre) administratorë , të cilët qendrojnë në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen për një periudhë maksimale prej (5 vitesh).
- 15.7. Çdo administrator do të ketë të drejtë për rimbussimin e shpenzimeve të bera prej tij për llogari të shoqërisë .
- 15.8. Kur administrator i shoqërisë rezulton i sukseshëm në punën e tij dhe në rezultatin financiar të kompanisë atëherë ortakët vendosin lidhur me shperblimin që do ti jepet atij në fund të vitit financiar.

NENI 16

Detyrat e Administratorit/ëve

16.1. Administratori i shoqërisë ka dhe këto detyra dhe të drejta.

- Të mirë administrojë pasurinë e shoqërisë.
- Të lidhë marrëveshje me të tretët brenda objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe kompetencave të caktuara nga ortakët.
- Të zbatojë rregullat e brendshme të shoqërisë.
- Të shpërblejë dëmet që i vijnë shoqërisë si pasoje e veprimeve apo mos veprimeve të tij.
- Të paguhet për punën e kryer në bazë të marrëveshjes së bërë midis tij dhe ortakëve.
- Të marrë të dhëna e të bëjë propozime mbi gjithçka që ai e quan të dobishme për shoqërinë.
- Të miratojë planet e llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre dhe ti paraqesë ato sipas rastit për miratimin përfundimtar nga ortakët.



- Të bëhen propozimet përkatëse ortakëve kur lind nevoja për ndryshime në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- Të miratojë aktet normative që përcaktojnë raportet në gjirin e shoqërise duke përfshirë kuadrin dhe personelin.
- Të përcaktojë strukturën e aparatit të shoqërisë dhe të krijojnë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
- T'i propozojë ortakëve për krijimin e njësive strukturave të ndryshme si filial, degë e përfaqësi në qytete të tjera të vendit ose jashte shtetit.
- Të përgatisë propozimin për pushimin e veprimtarisë së shoqërise dhe t'ia paraqesë ortakëve për miratim. Të përzgjedhë ekspertin kontabël dhe anëtare të komisionit të likuidimit si dhe të paraqesë propozimet për miratim para ortakëve .
- Të sigurojë zbatimin e përpiktë të Vendimeve të Ortakëve.
- Të kryejë çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga asambleja e ortakëve të shoqërisë.

KREU III MARDHENIET E PUNES

NENI 17

17.1. Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave të punës. Për çështjet që kjo kontratë nuk i parashikon zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 18

18.1. Për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis palëve dhe që nuk zgjidhet me mirëkuptim apo konsensus, organi kompetent për zgjidhjen e saj është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 19 Sekreti i punës

19.1. Të gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë. Kjo detyrë vazhdon edhe pas largimit të tyre nga shoqëria.



KAPITULLI I IV
VITIT FINANCIAR, BALANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT

NENI 20
Viti financiar

20.1. Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti. Përfundimisht, viti i parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe përfundon me 31 dhjetor të të njëjtit vit.

NENI 21
Inventari dhe llogaritë vjetore.

21.1. Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore.

22.1. Në mbylljen e vitit financiar administratori harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për vitin financiar.

NENI 22
Raportet vjetore

22.1. Në mbylljen e çdo viti financiar administratori ose sipas rastit eksperti kontabël harton inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për kontabilitetin si dhe harton një raport me shkrim për ortaket.

22.2. Raporti pasqyron gjëndjen e shoqërisë gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme etj.

22.3. Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga ortaket sipas Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 23
Rezerva e domosdoshme dhe e nevojshme.

23.1. Nga fitimi i realizuar gjatë vitit financiar pasi zbriten humbjet e vitit të mëparshëm, hiqet menjëherë një shume e barabarte me 5 %(pesë përqind) e fitimit e destinuar për formimin e fondit rezervë të quajtur "rezervë e domosdoshme".



23.2. Heqja nga fitimi për rezervën e domosdoshme pushon së qeni e detyrueshme kur kjo rezervë arrin 10 % të kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur për një arsye çfarëdo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nën 10% e kapitalit.

23.3. Ortakët mund të vendosin edhe zbritje të veçantë në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo për shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

NENI 24

24.1. Të ardhurat eventualisht të ndjekura nga shoqëria çdo vit financiar janë të destinuara siç është vendosur nga ortakët duke i qëndruar në uljen 5 % që do t'i destinohet rezervës ligjore.

KAPITULLI V MBYLLJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI

NENI 25

25.1. Veprimtaria e shoqërisë mund të ndërpritet para afatit kur shoqëria nuk rezulton rentable gjatë dy vjetëve të fundit radhazi dhe kur për këtë vendos gjykata kompetente.

NENI 26

26.1. Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, ortakët caktojnë një likuiditor, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar. Shoqëria gjatë likuidimit mban anash emërtimit dhe emrin "Shoqëri në likuidim e siper".

26.2. Likuiditori i emëruar nga ortakët menjëherë sapo merr detyrën është i detyruar të publikojë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vejë në dispozicion menjëherë ortakeve.

26.3. Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.



NENI 27

27.1. Ortakët vendosin mbi rregullshmërinë e likuidimit, për të vendosur për bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit të likuiditorit.

27.2. Ortakët mund të vendosin vetë realizimin e kësaj mbledhje, në rast se likuiditori nuk e kërkon. Mbledhja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakëve ose të një mandatmbajtësi të caktuar prej tij.

NENI 28

28.1. Kur ortakët për shkaqe të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likuidimit.

28.2. Aktet e mbylljes dhe likuidimit pas depozitimit të dokumentacionit në regjistrin tregtar Shoqëria ç'regjistrohet prej tij.

DISPOZITET KALIMTARE

NENI 29

Dispozitat e fundit

29.1. Për të gjitha çështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

29.2. Për efekt të inteprentimit të këtij Statuti me Ligj Tregtar nënkuptohet Ligji nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

29.3. Pavlefshmëria eventuale të dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të cenojnë vlefshmërinë e tij.

NENI 30

Gjykata kompetente.

30.1. Gjykata kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve dhe interpretimin e Statutit të Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



NENI 31

Hyrja ne fuqi

31.1. Ky Statut dhe Akt themelimi hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e firmosjes nga Ortaket.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

"IRTech Renewables" sh.p.k.

1. Z. Igli Reçi

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Igli Reçi', with a large, stylized flourish below it.